



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.306, datë 21.11.2022

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS PJESORE TË KANDIDATËVE PËR T’U PRANUAR NË
PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR SË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS NË VITIN AKADEMIK 2022-2023”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe 161 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 32 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreun VI, Seksionit Ç, pika 8, germa “a” të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës pjesore të kandidatëve, për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar së Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2022-2023, si më poshtë:
 - a. Zonja Elida Grabovari
2. Të njoftohen për këtë vendim kandidatët e mësipërm dhe Shkolla e Magjistraturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 21.11.2022.

KRYETARI

Alfred Balla

